



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec
RAHOVEC / GRAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/127 Nr. i faq./Br.sti/No.pg 86

Data/Datumi/Date 24.07.2020

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c), nenit 17 dhe nenit 40 pika 2 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 12, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 24.03.2020, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR SHËRBIME PUBLIKE 01 Nr. 2917, e datës 26.10.2018

Neni 1

Neni 2 paragrafi 1 pika 1.9 i Rregullores bazike, ndryshohet me tekstin si në vijim:

1.9. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal dhe numërizimi i rrugëve, i shesheve dhe i hapësirave të tjera publike.

Neni 2

Neni 36 paragrafi 1 pika 1.10 e rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

1.10. Derdhja e ujit të pijes dhe e ujit të puseve në rrugë dhe në trotuare, me qëllim freskimi dhe pastrimi.

Neni 3

Në nenin 53 paragrafi 1 të rregullores bazike, pas pikës 1.18., shtohet pika 1.19., me tekstin si në vijim:

1.19. Ndalohet hedhja e mbeturinave në sipërfaqe publike (në rrugë, në trotuare, në parkingje, në varreza, në toka bujqësore etj.).

Neni 4

Në nenin 57 të rregullores bazike, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi 3, me tekstin si në vijim:

3. Vendosja e pengesave në rrugë (policë të shtrirë), të bëhet me leje të organit kompetent dhe të vendoset sipas kriterëve të përcaktuara. Në rast të vendosjes pa autorizim të organit kompetent, gjobiten nga inspektori komunal personat fizikë dhe juridikë.

Neni 5

Neni 61 i rregullores bazike paragrafi 4, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

4. Ndalohet hedhja e dheut, e rërës, e gurëve, e mbetjeve të shtazëve të ngordhura, të fherura etj., nëpër trotuare, në sheshe të vogla, në rrugë dhe në sipërfaqe të tjera publike dhe private.

Neni 6

Në nenin 62 të rregullores bazike, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi 6, me tekstin si në vijim:

6. Leja për punime për vendosjen, për zhvendosjen dhe për rivendosjen e shtyllave elektrike të jepet nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 7

Në nenin 107 të rregullores bazike, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi 4, me tekstin si në vijim:

4. Në rast të këputjes apo të varjes së kabllave elektrike apo të çfarëdo kabllave tjetër, njoftimi të bëhet nga Inspektorati Komunal dhe në një afat sa më të shkurtër, operatori ekonomik të bëjë rregullimin apo largimin e tyre.

Neni 8

Në nenin 149 paragrafi 1 i rregullores bazike, pas pikës 1.27., shtohen pikat 1.28., 1.29. dhe 1.30., me tekstin si në vijim:

1.28. Vendosja e kondicionerëve në objekte private ose kolektive, pa u siguruar se i njëjti nuk pengon fqinjën dhe rrjedhja e ujit nga ana e tyre në hapësirat publike apo private.

1.29. Vendosja e kabllave të telefonisë mobile, të internetit, të kamerave të sigurisë apo të çfarëdo kabllave tjetër në shtyllat e ndriçimit publik.

1.30. Krijimi i deponive ilegale në parcelat e pronarëve privatë.

Neni 9

Në nenin 155 të rregullores bazike, në paragrafin 5, shuma “50 €” zëvendësohet me shumën “nga 50 € deri në 500€”.

Neni 10

1. Në nenin 156 të rregullores bazike, në paragrafin 1, shuma “20€ deri 1,000€”, zëvendësohet me shumën “50€ deri 5,000€”.

2. Në nenin 156 të rregullores bazike, në paragrafin 2, shuma “50€ deri 3,000€”, zëvendësohet me shumën “150€ deri 5,000€”.

3. Në nenin 156 të rregullores bazike, në paragrafin 3, shuma “150€ deri 10,000€”, zëvendësohet me shumën “250€ deri 10,000€”.

4. Në nenin 156 të rregullores bazike, në paragrafin 5, shuma “50€”, zëvendësohet me shumën “500€”.

Neni 11

1. Në nenin 157 të rregullores bazike, në paragrafin 1, shuma “20€ deri 1,000€”, zëvendësohet me shumën “50€ deri 5,000€”.

2. Në nenin 157 të rregullores bazike, në paragrafin 2, shuma “50€ deri 3,000€” zëvendësohet me shumën “150€ deri 5,000€”.

3. Në nenin 157 të rregullores bazike, në paragrafin 3, shuma “150€ deri 10,000€”, zëvendësohet me shumën “250€ deri 10,000€”.
4. Në nenin 157 të rregullores bazike, në paragrafin 4, pika 4.18, numri “26”, zëvendësohet me numrin “30”.

Neni 12

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale do të jetë pjesë e tekstit bazë të rregullores në fuqi.

Neni 13

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky ndryshim dhe plotësim i Rregullores për Shërbime Publike hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.127/26
Datë:24.03.2026


Fatmir Iska
Kryesues i Kuvendit

